



BORDI I ANKESAVE PËR MEDIA
MEDIJSKI ODBOR ZA ŽALBE
MEDIA APPEALS BOARD

Bordi i Ankesave për Media

Duke vepruar në bazë të autoritetit të dhënë më Ligjin No. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media ("KPM") dhe Transmetim mbi licencimin dhe rregullimin e mediave transmetuese në Kosovë, neni 24.2(a), Bordi i Ankesave për Media ("Bordi"), përmes kësaj miraton Rregullat e Procedurës në bazë të së cilës do të udhëhiqen seancat në lidhje më Ankesat kundër vendimeve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Këto Rregulla të procedurës janë miratuar unanimitet nga Bordi i Mediave për Ankesa – Wolfgang Benedek (kryetar), Anton Nokaj (anëtar), dhe Avdi Dinaj (anëtar) – më 7 maj 2007.

Rregullat e Procedurës

Dorëzimi i Ankesave

1. Ankesë Apelimi dhe të gjitha dokumentet mbështetëse do të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh pas lëshimit të një vendimi nga ana e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media ("Këshilli i KPM"-së) që i nënshtrohet Ankesë Apelimit në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme. Një Ankesë Apelim duhet të cekë numrin dhe datën e vendimit të KPM-së të cilit i referohet. Ankesë Apelimi i drejtuar Bordit, duhet të dorëzohet nëpërmjet zyrës së KPM-së.
2. Pala Ankuese duhet të paraqesë ndonjë fakt ose argument ligjor që nuk është shqyrtuar më parë nga Këshilli i KPM-së ose të pohojë se Këshilli i KPM-së ka bërë një gabim faktik, ligjor ose procedural gjatë

marrjes së vendimit të instancës së parë. Ankesë Apelimi duhet të specifikojë kundërshtimin e një apo më shumë aspekteve të vendimit të Këshillit të KPM-së në vijim:

- a) zbulimi i fakteve,
- b) interpretimi i ligjit,
- c) procedura dhe
- d) sanksioni apo kushti i vendosur.

Pala Ankuese duhet gjithashtu të parashtroj propozim konkret se çka kërkon nga Bordi.

3. Këshilli i KPM-së duhet të përgatit përgjigje ndaj Ankesë Apelimit, së bashku me çfarëdo dokumenti mbështetës që KPM-ja e konsideron si të arsyeshme. Këshilli i KPM-së do t'ia dorëzojë këtë përgjigje Bordit jo më vonë se tetë (8) ditë para seancës së shqyrtimit, në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe (si dhe në gjuhën serbe, nëse është e nevojshme), të cilat do të jenë në dispozicion të Palës Ankuese jo më vonë se tetë (8) ditë para seancës së Bordit, në të cilën Bordi do të shqyrtojë Ankesë Apelimin. Pala Ankuese nuk ka të drejtë të dorëzojë ndonjë kundërshtim të mëtejshëm me shkrim, por mund të përgjigjet para Bordit gjatë seancës së shqyrtimit.
4. Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së do t'ia dorëzojë Bordit kopje të dokumenteve në vijim jo më vonë se tetë (8) ditë para seancës së Bordit në të cilën Bordi do të shqyrtojë një Ankesë Apelim:
 - a) vendimi ndaj të cilit parashtrohet ankesë Apelimi
 - b) Ankesë Apelimi më dokumentacionin mbështetës
 - c) përgjigja e Këshillit të KPM-së së bashku më dokumentacionin mbështetës.

Provat dhe shkresat

5. Barra e paraqitjes së fakteve mbi të cilat mbështetet pala do të bie mbi atë palë.
6. Zyra e Shefit Ekzekutiv e KPM-së do t'ia ofrojë Palës Ankuese qasje, në

- bazë të kërkesës, në të gjitha dokumentet në dosjen e rastit të KPM-së.
7. Ankesë Apelimet do të dorëzohen dhe nënshkruhen nga Pala Ankuese në gjuhën shqipe apo serbe. Ankesë Apelimeve mund t'i bashkëngjitet dokumentacioni mbështetës.
 8. Me kërkesën e parashtruar, Bordi mund të pranojë dokumente me shkrim nga palët e treta të cilat kanë interes në proces. Në raste të veçanta, Bordi mund të ftojë palën e tretë që të paraqitet para Bordit.

Delegimi i funksioneve

9. Bordi mund t'i delegojë Zyrës së Shefit Ekzekutiv rishqyrtimin e kriterëve lidhur me pranimin e Ankesë Apelimeve, të cekura në nenin 1 dhe 2, si dhe lidhur me saktësinë e provave të cekura në nenet 5-8, të cilat detyra do të kryhen nën mbikëqyrjen e Bordit.

Seancat dhe gjuhët

10. Zyra e Shefit Ekzekutiv e KPM-së do ta njoftojë Palën Ankuese, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës së Bordit, se Bordi do të diskutoj lidhur me Ankesë Apelimin. Ky njoftim do t'i ofrojë Palës Ankuese mundësinë të kërkoj, brenda afatit prej tri (3) ditësh, në qoftë se Pala Ankuese dëshiron të ketë një dëgjim para Bordit. Qëllimi i dëgjimit është që Palës Ankuese t'i ipet mundësia për të sqaruar Ankesë Apelimin sipas kriterit në Rregullën 2 të lartpërmendur.
11. Në qoftë se Pala Ankuese nuk paraqet kërkesë për dëgjim brenda afatit kohor, Bordi mund ta shqyrtoj Ankesë Apelimin në seancë duke u bazuar në shkresat e dorëzuara.
12. Seancat para Bordit do të jenë të mbyllura. Bordi vendos për lejimin e pjesëmarrjes së vëzhguesve në seanca pas konsultimit me palët.
13. Seancat shqyrtuese do të mbahen në gjuhën angleze dhe shqipe/ose serbe me përkthim simultant apo të vazhdueshëm, sipas nevojës.

Palët në seancë

14. Pala Ankuese dhe Këshilli i KPM-së kanë të drejtë të jenë prezent në seancë shqyrtimi.
15. Pala Ankuese mund të përfaqësohet nga juristi i emëruar zyrtarisht.
16. Këshilli i KPM-së mund të përfaqësohet nga Shefi Ekzekutiv apo zyrtari ligjor i emëruar zyrtarisht.
17. Palët kanë të drejtë të lajmërohen me shkrim, për kohën, datën dhe vendin ku do të mbahet seanca, më së paku tetë (8) ditë para se të mbahet e njëjta.

Organizimi i procesit

18. Kryetari i Bordit do të caktoj rrjedhën e seancës.
19. Cilido anëtar i Bordit mund të parashtrojë pyetje apo të kërkojë komente nga Pala Ankuese apo Këshilli i KPM-së lidhur me çfarëdo çështje ligjore ose faktike që ka të bëjë me procesin.
20. Bordi mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje, që parashtrohet nga cilado palë, gjatë procesit.
21. Bordi, sipas vendimit të vet apo sipas kërkesës së cilës do palë, mund të shtyj seancën për aq kohë sa konsiderohet e nevojshme.
22. Bordi mund të marrë vendime të nevojshme për të udhëhequr procesin para tij në mënyrë të rregullt dhe më kohë.

Vendimet e Bordit

23. Vendimet e Bordit do të merren me shumicë votash.
24. Vendimi i Bordit do të jetë me shkrim dhe do të jetë i arsyetuar. Një anëtar i Bordit mund të shprehë mendim të pavarur ose kundërshtues.
25. Bordi me vendimin e tij do të miratojë, ndryshojë ose anulojë vendimin e shqiptuar nga Këshilli i KPM-së. Arsyetimi i vendimit do të përmbajë konkluzionet e Bordit për faktet materiale, konkluzionet bazuar në ligjin në fuqi dhe vendimin e tij mbi aplikimin e ligjit në faktet e gjetura, duke pasur parasysh lirinë e gjykimit.

26. Procesverbali i votimit do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Bordit, si një dokument i brendshëm i Bordit. Anëtari që është kundër mund ta shënoj votën e tij kundër. Vendimi i Bordit, me arsyetimin e plotë, duhet të lëshohet si një dokument tjetër, i nënshkruar nga kryetari i Bordit.
27. Vendimet e Bordit janë përfundimtare dhe u nënshtrohen shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi.
28. Vendimi do t'i dorëzohet palëve në gjuhën e tyre, dhe do të bëhet publik në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze. Të gjitha vendimet si dhe rregullat e Procedurës të Bordit do të publikohen në web-faqen e KPM-së.